



Njëri nga thirrësit islam është ulur para një dijetari dhe po i rrëfente përvojën e tij në davet-thirrje, dhe rreth vetes kishte ushtarë Kinez të cilët kishin marrë pjesë në luftën e tretë të Khalixhit-Gjirite.

Dijetari e kishte ulur kokën dhe po e dëgjonte me vëmendje thirrësin islam duke i treguar historinë e tyre.

I tha: “Këta kanë ardhur t’i bashkëngjiten operacioneve mbështetëse në veri të Arabisë Saudite. Ndërsa, ne thirrësit ishim të obliguar t’i ftonim në rrugën e Allahut, t’i nxjerrim nga padrejtësitë dhe errësirat e shirkut-politeizmit, t’i nxjerrim nga adhurimi i Budës, Konfushiose dhe putave të tjerë në adhurimin drejt Allahut që është i Pashoq.

O Dijetarë: Allahu na ka dhënë suksese në davetin tonë, kështu që një numër i konsiderueshëm i tyre pranuan Islamin, dhe filluam t’ua mësojmë kushtet e fesë, farzet dhe vaxhibet.

Ata njëmend filluan ta falnin namazin në kohën e vet, larg syve të gjeneralëve dhe përgjegjësve të tyre, mirëpo problemi nuk qëndronte as në namazin e drekës, ikindisë, akshamit, e as të jacisë; por, ata gjetën vështirësi në namazin e sabahut!!!

Kur përgjegjësit kuptuan se ata ishin mbledhur në një kazermë, ashtu që të kujdestarojnë me rend për t’i zgjuar shokët për namazin e sabahut, ata i shpërndanë nëpër kazerna të ndryshme. Pas kësaj çdo njëri prej tyre morri nga një orë, nuk shkoi gjatë dhe ata ua ndaluan edhe orët.

Saherë që këta gjenin një metodë për t’u zgjuar në namazin e sabahut, ata i luftonin dhe ua mbyllnin të gjitha rrugët.

Çuditërisht ata shpikën një metodë të re për t’u zgjuar në namazin e sabahut!

Dijetari filloi të shikojë drejt thirrësit me një vëmendje më të theksuar, e po ashtu edhe ndaj

ushtarëve që ishin rreth tij; ndërsa ata po shikonin drejt Dijetarit me respekt dhe mallëngjime.

Thirrësi vazhdoi fjalimin e tij: “O dijetarë, çdo njëri prej tyre ka vendosur të pijë një sasi të madhe uji para gjumit, me qëllim që të zgjohen natën më shpesh për në tualet. Kështu ata shikonin orën dhe e dinin se sa kohë ka mbetur për namazin e sabahut; nëse koha ishte afër pritnin dhe faleshin, në të kundërtën pinin edhe ca gota!

Pasi provuan këtë metodë dhjetëra herë. Arritën të dinë sasinë e duhur të pirjes së ujit para gjumit që i bën ata të zgjohen në kohën e saktë të sabahut; kështu iu bë e mundur çdo njërit prej tyre ta falin sabahun në kohën e vet!”

Pasi thirrësi-islam përfundoi, shikoi drejt fytyrës së Shejhut dhe pa se ai po qante!

Ata janë të rinj’ në Islam; dashuria e madhe në zemrat e tyre për Islamin është në një shkallë të lartë... athua pse ata e njohën injorancën dhe të këqijat e saj, dhe kanë njohur Islamin dhe lumturinë e tij dhe e përqaftuan.

Ku jemi ne, në krahasim me ata?!

Për fat të keq, ka nga ne që nuk e fal namazin e sabahut asnjëherë, edhe pse e dëgjon ezanin nga xhamia që ka afër shtëpisë së tij, dhe nuk i përgjigjet pa asnjë arsye. E disa prej robërve të Allahut humbin namazin e natës edhe pse ata faleshin ditën, duke menduar se i kanë dhuruar vetes së tyre rehati dhe gjumë, duke menduar se ai ka fituar!!! Ka edhe të atillë që nuk e falin namazin kurrë, as ditën as natën.

Allahu ka thënë: “Që të mos thotë shpirti: “I mjeri unë, sa obligime më kanë mbetur vetëm ndaj Allahut, madje edhe jam tallur.” (Zumer, 56)

Përktheu: Valdet Kamberi